




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR SHKUMBIN

VENDIM

Nr. 01, datë 25.01.2024



**PËR**  
**MOS MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM BURIMI UJOR”**  
**ME QËLLIM SHFRYTËZIMIN E MATERIALEVE INERTE QË**  
**NXIRREN NGA SHTRETËRIT E LUMENJVE, PËRRENJVE, LIQENEVE,**  
**ME OSE PA UJË, ME VENDNDODHJE: SHTRATI I LUMIT GOSTIMË,**  
**BASHKIA ELBASAN, QARKU ELBASAN**  
**SUBJEKTIT “4 A-M”**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020 “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin,

**V E N D O S I.**

- 1. Mos miratimin e lejes, “Për përdorim burimi ujor”, me qëllim shfrytëzimin e materialeve inerte që nxirren nga shtretërit e lumenjve, përrenjve, liqeneve, me ose pa ujë me vendndodhje: Shtrati i Lumit Gostimë, Bashkia Elbasan, Qarku Elbasan, subjektit “4 A-M” për zbatimin e projektit “Zgjerimi i rrugës Elbasan Qafi Thanë, (Faza II)” REF-64067-03-29-2023 me Nr. 2769/6, prot, datë 27.6.2023, për arsye se marrja e inerteve në këtë zonë do të shkaktojë në shkatërrimin e veprave**



**mbrojtëse, ujitëse (kanali vaditës) dhe urat, investime keto të Bashkisë Elbasan.**

Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit te subjektit te interesuar.

**KRYETARI I KBU SHKUMBIN**

